



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

**P.nr.30/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, në lëndën penale, ndaj të pandehurit I. R., nga fsh. M. K. L., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.8255/13 të dt.20.01.2014, për shkak të veprës penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.01.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Fartmire Cacaj, dhe të pandehurit, në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpall këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit:

I. R., nga i ati I., i lindur në vitin *viti i lindjes...*, me nr. personal *numër personal...*, nga fsh. M. K. L., ku edhe jeton, Shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet ne liri.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse:

Prej datës së pacaktuar e deri me datën 25.10.2013, në shtëpinë e tij që gjendet në fshatin M. K. L., me qëllim që vetit ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që në mjehsorin elektrik nr....., ka larguar tri urat, dhe është bërë i pamundur regjistrimi i energjisë elektrike, me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast të dëmtuarës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, (K.), i ka shkaktuar dëm në vlerë rreth 294.90-€.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e,

**G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200-€, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen veprën tjetër penale.

DETYROHET i akuzuari që të dëmtuarës K.-Departamentit Ligjor në Prishtinë t'ia kompensojë shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 294.90-€ në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.nr.8254/13 të dt.20.01.2014, e ka akuzuar të pandehurin I. R., nga fsh. M. K. L., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranim ky i bërë në mënyrë të vullnetare, pa presjon dhe konform dispozitave nenit 248 KPRK-së, dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëherit shton se shtëpia ende ka qenë e pabanuar por vetëm duke punuar mjeshtrit dhe punëtorët e K., në mënyrë të pandërgjegjeshme nga se e kanë ditur se askush nuk banon në këtë shtëpi sepse ende ka qenë e parregulluar në tërësi, kanë bërë fletparaqitje penale dhe më kanë ngarkuar kinse për rikthim të humbjeve në shumën prej 294-€, të cilin dëm në tërësi e kam paguar, për çka gjykatës ia prezentoj faturën e pagesës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për detyrimin e të akuzuarit që t'ia kompensojë dëmin respektivisht kërkesën pasurore- juridike, të dëmtuarës u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.**

**P.nr. 30/14 dt. 01.02.2017**

Sekretarja juridike  
Nexhmije Ahmeti

**GJYQTARI**  
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.